



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT  
KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Burrel, më \_\_\_\_\_.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “HB-GROUPCONSTRUCTION”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L87812902D**, me seli: *Dibër, Burrel, BURREL, Lagjja “Pjetër Budi”, Rruga “Pirustët”, Pallati 14, Ap. 1.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar - Punë”, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: REF-76049-07-26-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rehabilitimin e segmentit të rrugës fshatit Shqefen, të urës fshatit Gërman të dëmtuara nga shirat e dendur dhe të rrëmbyeshëm si dhe nga prurjet e mëdha të përroit të fshatit Gërman, Bashkia Mat”, me fond limit në vlerën: **2 083 336** (dy milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, nga grand i bashkisë, me afat realizimi: **60** (gjashtëdhjetë) **ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 66, datë 31 Korrik 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori Ekonomik: “HB-GROUPCONSTRUCTION”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L87812902D.**

Vlera: **2 063 116** (dy milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

**2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Progres Shkodra”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **M17324001D**, dhe **“S.M.O.UNION”** Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J66902042Q.**

Vlera: **1 643 208** (një milion e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Progres Shkodra” Sh.p.k., me numër Nipt-i: M17324001D, dhe “S.M.O.UNION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J66902042Q.**

*Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, shoqëria “S.M.O.UNION” Sh.p.k., dhe shoqëria “Progres Shkodra” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

**I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.2/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga anëtar i B.O.E., shoqëria “Progres Shkodra” Sh.p.k., konstatohet se, bilancet e paraqitura për vitet financiare 2021, 2022 janë të pakonfirmuara nga autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore).**

**II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.3.1 *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*

– *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllëguar të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

*ose*

– *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100% e fondit limit të kontratës që prokurohet.*

***Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.***

*Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
  - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
  - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
  - vii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.
- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
  - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
  - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga anëtari i B.O.E., shoqëria “Progres Shkodra” Sh.p.k., konstatohet se:**
1. **Nuk është paraqitur miratimi i Autoritetit Kontraktor për Kontratën e Nënkontraktimit me shoqërinë “Progres Shkodra” Sh.p.k., si dhe kontrata e nënkontraktimit nuk është bërë sipas formës së kërkuar nga ligji (e noterizuar), parashikuar këto në nenin 126 të LPP-së dhe nenin 89 të VKM-së nr. 285, dt.19.05.2021, (të njëjtin përcaktim ka dhe ligji ekzistues i prokurimit publik).**
  2. **Formulari i Vlerësimit për nënkontraktorin nuk është dhënë nga ana e Autoritetit Kontraktor, Akti i Kolaudimit nuk është kryer nga kolaudator i licencuar, si dhe Faturat Tatimore nuk janë lëshuar sipas legjislacionit tatimor.**
- **Gjithashtu, në dokumentacionin e paraqitur nga anëtari i B.O.E., shoqëria “S.M.O.UNION” Sh.p.k., konstatohet se nuk janë paraqitur të gjitha faturat tatimore shitje për të gjitha punimet e kryera sipas vlerës së situacionuar, si dhe faturat e paraqitura nuk janë të plotësuara sipas legjislacionit tatimor (mungon nënshkrimi i blerësit).**

**III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.2/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.3.2 *Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

- ***Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:***
  - ***Kategoria NP-1 (Punime gërmimi në tokë) – Klasifikimi A***
  - ***Kategoria NP-4 (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale) – Klasifikimi A***
  - ***Kategoria NP-5 (Punime nëntokësore, ura e vepra arti) – Klasifikimi A***
  
- ***Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:***
  - ***Kategoria NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve) – Klasifikimi A***
  - ***Kategoria NS-8 (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri) – Klasifikimi A***
  - ***Kategoria NS-9 (Punime strukturorë speciale) – Klasifikimi A***

*\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

*\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik, pasi bazuar në tabelën e ndarjes së punimeve, konstatohet se shoqëria “Progres Shkodra” Sh.p.k., ka marrë përsipër punime për të cilat nuk disponon kategorinë përkatëse në liçencën për zbatimin e punimeve të ndërtimit, konkretisht nuk disponon: Kategorinë NP-5 - në lidhje me zërat e punimeve në preventiv të cilat konsistojnë në riparimin e bazamentit mbështetës të Urës së fshatit Gërman me qëllim mbrojtjen nga gërryerjet, kategorinë NS-8 - në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (Fv. Hekur betoni, Strukturë monolite betoni), kategorinë NS-9 - në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (Garbiona me rrjete teli, mbushje me zhavor etj.).**

IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6 gërma “a” dhe “b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 (Makineri, Pajisje)

a) *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;*

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes</b>	<b>Sasia</b>
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	jo më pak se 1 copë
2.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	jo më pak se 1 copë
3.	Eskavator me zinxhir ose goma	jo më pak se 1 copë
4.	Betoniere 0.25 - 0.5 m <sup>3</sup>	jo më pak se 2 copë
5.	Panele dërrasë	jo më pak se 100 m <sup>2</sup>
6.	Vibrator Betoni	jo më pak se 1 copë
7.	Matrapik	jo më pak se 1 copë
8.	Pompë zhytëse	jo më pak se 2 copë
9.	Karroçë dore	jo më pak se 4 copë

b) *Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:*

- Kokore – jo më pak se 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 2 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – jo më pak se 1 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 10 copë...

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr.8, konstatohet se, Anëtari i B.O.E. shoqëria “Progres Shkodra” Sh.p.k., nuk disponon makinerinë eskavator për kryerjen e punimeve që ka marr përsipër (Gërmime dheu me eskavator...) si dhe Seksioni C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/ pajisje/ makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, nuk është plotësuar saktë me të gjitha të dhënat që kërkohen, ku:**

1. Anëtari i B.O.E. shoqëria “Progres Shkodra” Sh.p.k., nuk ka deklaruar të dhënat e Faturave Tatimore për pajisjet: *Betoniere 0.25 – 05 m<sup>3</sup>, Panele dërrasë, karrocë dore,* si dhe nuk ka deklaruar disponimin e mjeteve/pajisjeve për mbrojtjen në punë të punëtorëve.
2. Anëtari i B.O.E. shoqëria “S.M.O.UNION” Sh.p.k., nuk ka deklaruar të dhënat e Faturave Tatimore për pajisjet e punimeve dhe mjeteve/pajisjeve për mbrojtjen në punë të punëtorëve.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“HB-GROUPCONSTRUCTION”** Sh.p.k., me seli: *Dibër, Burrel, BURREL, Lagjja “Pjetër Budi”, Rruga “Pirustët”, Pallati 14, Ap. 1*, me numër Nipt-i: **L87812902D**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **2 063 116** (dy milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: *Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10** (dhjetë) **ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**